



United Nations  
Nations Unies



International Criminal Tribunal  
for the former Yugoslavia  
Tribunal Pénal International  
pour l'ex-Yougoslavie

(IT-04-84)

# HARADINAJ dhe të tjerë.

*Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*

## RAMUSH HARADINAJ

*U shpall i pafajshëm*




Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në Zonën Operative të Dukagjinit, që ndodhet në perëndim të Prishtinës, e cila përfshinte komunat e Pejës, Deçanit, Gjakovës, dhe pjesë të komunave të Istogut dhe Klinës; gjithashtu i njohur si "Smajl".

- Liruar prej akuzave

<b>I lindur më</b>	3 korrik 1968 në Glllogjan, Kosovë
<b>Aktakuza</b>	Fillestare: 4 mars 2005, u publikua më 10 mars 2005; u ndryshua më 25 tetor 2006; e rishikuar e ndryshuar për herë të dytë: 12 janar 2007; e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2007; e ndryshuar për herë të katërt: 15 tetor 2007
<b>U dorëzua</b>	9 mars 2005
<b>U transferua në TPNJ</b>	9 mars 2005
<b>Paraqitja e parë dhe paraqitjet e tjera</b>	14 mars 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat; 1 mars 2007 u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat
<b>Vendimi i Dhomës Gjyqësore</b>	3 prill 2008, u shpall i pafajshëm dhe u lirua
<b>Vendimi i Dhomës së Apelit</b>	21 korrik 2010, u urdhërua rigjykim i pjesshëm
<b>Vendimi i rigjykimit</b>	29 nëntor 2012, u lirua prej akuzave

## IDRIZ BALAJ

*U shpall i pafajshëm*



Anëtar i UÇK-së, shërbeu si komandant i njësisë së posaçme e quajtur 'Shqiponjat e Zeza'; ishte vartës i Ramush Haradinajt, gjithashtu i njohur si "Togeri".

- Liruar prej akuzave

<b>I lindur më</b>	23 gusht 1971 në Gllarevë, komuna e Klinës, Kosovë
<b>Aktakuza</b>	Fillestare: 4 mars 2005, u publikua më 10 mars 2005; u ndryshua më 25 tetor 2006; e rishikuar e ndryshuar për herë të dytë: 12 janar 2007; e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2007; e ndryshuar për herë të katërt: 15 tetor 2007
<b>U dorëzua</b>	9 mars 2005
<b>U transferua në TPNJ</b>	9 mars 2005
<b>Paraqitja e parë dhe</b>	14 mars 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat; 1 mars 2007 u

paraqitjet e tjera	vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat
Vendimi i Dhomës Gjyqësore	3 prill 2008, u shpall i pafajshëm dhe u lirua
Vendimi i Dhomës së Apelit	21 korrik 2010, u urdhërua rigjykim i pjesshëm
Vendimi i rigjykimit	29 nëntor 2012, u lirua prej akuzave

**LAHI BRAHIMAJ***U shpall fajtor për trajtim mizor dhe torturim*

Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së me bazë në shtabin e Jabllanicës në komunën e Gjakovës; shërbeu si zëvendëskomandant në zonën e Dukagjinit për një periudhë të shkurtër; ishte vartës dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Ramush Haradinajt; njihej me pseudonimin "Magjupi"

- U dënua me gjashtë vjet burgim

I lindur më	26 janar 1970 në Jabllanicë, komuna e Gjakovës, Kosovë
Aktakuza	Fillestare: 4 mars 2005, u publikua më 10 mars 2005; u ndryshua më 25 tetor 2006; e rishikuar e ndryshuar për herë të dytë: 12 janar 2007; e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2007; e ndryshuar për herë të katërt: 15 tetor 2007
U dorëzua	9 mars 2005
U transferua në TPNJ	9 mars 2005
Paraqitja e parë dhe paraqitjet e tjera	14 mars 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat; 1 mars 2007 u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat
Vendimi i Dhomës Gjyqësore	3 prill 2008, u dënua me gjashtë vjet burgim
Vendimi i Dhomës së Apelit	21 korrik 2010, u la në fuqi dënimi (u urdhërua rigjykim i pjesshëm)
Vendimi i rigjykimit	29 nëntor 2012, u lirua prej akuzave

**TË DHËNA**

Ditët e gjykimit	113
Dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria	81
Prova materiale të Prokurorisë	1044
Dëshmitarë të thirrur nga Mbrojtja	0
Prova materiale të Mbrojtjes	145

GJYKIMI	
Filloi	5 mars 2007
Argumentet përmbyllëse	21-23 janar 2008
Dhoma Gjyqësore I	Gjykatësi Alphons Orië (kryesues), Gjykatësi Frank Höpfel, Gjykatësi Ole Bjørn Støle
Avokatët e Prokurorisë	David Re, Gilles Dutertre, Patricia Sellers, Gramsci di Fazio, Anees Ahmed, Katrina Gustafson
Avokatët e Mbrojtjes	Për Ramush Haradinajn: Ben Emmerson, Rodney Dixon dhe Andrew Strong Për Lahi Brahimajn: Richard Harvey, Paul Troop

	Për Idriz Balajn: Gregory Guy-Smith
Shpallja e vendimit	3 prill 2008

APELI	
Dhoma e Apelit	Gjykatësi Patrick Robinson (kryesues), Gjykatësi Fausto Pocar, Gjykatësja Andréia Vaz, Gjykatësi Liu Daqun, Gjykatësi Theodor Meron
Avokatët e Prokurorisë	Peter Kremer
Avokatët e Mbrojtjes	Për Ramush Haradinajn: Ben Emmerson, Rodney Dixon Për Lahi Brahimajn: Richard Harvey, Paul Troop Për Idriz Balajn: Gregory Guy-Smith, Colleen Rohan
Shpallja e vendimit	21 korrik 2010

RIGJYKIMI	
Filloi	18 gusht 2011
Argumentet përmbyllëse	25-27 qershor 2012
Dhoma Gjyqësore II	Gjykatësi Bakone Justice Moloto (kryesues), Gjykatësi Burton Hall dhe Gjykatësi Guy Delvoie
Avokatët e Prokurorisë	Paul Rogers, Daniela Kravetz, Barbara Goy, Aditya Menon
Avokatët e Mbrojtjes	Për Ramush Haradinajn: Ben Emmerson, Rodney Dixon, Andrew Strong Për Lahi Brahimajn: Richard Harvey, Paul Troop Për Idriz Balajn: Gregory Guy-Smith, Colleen Rohan
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	29 nëntor 2012

Ditët e rigjykimit	35
Dëshmitarë të Prokurorisë	56
Prova materiale të Prokurorisë	528
Dëshmitarë të Mbrojtjes	0
Prova materiale të Mbrojtjes	219

ÇËSHTJE E TJERA QË KANË LIDHJE nga rajoni gjeografik
LIMAJ e të tjerë (IT-03-66)
MILLOSHEVIQ (IT-02-54) "KOSOVË, KROACI & BOSNJË"
SHAINOVIQ e të tjerë (IT-05-87) "KOSOVË"

## AKTAKUZA DHE AKUZAT

Aktakuza fillestare kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt u konfirmua më 4 mars 2005 dhe u publikua më 10 mars 2005. Më 26 prill 2006, Prokuroria parashtroi një aktakuzë të ndryshuar dhe më 25 tetor 2006 Dhoma Gjyqësore e konfirmoi atë aktakuzë si dokumentin në fuqi për këtë çështje gjyqësore. Pas konstatimit të gabimeve në atë parashtrim, Prokuroria parashtroi aktakuzën e ndryshuar për herë të dytë të rishikuar më 10 nëntor 2006, e cila u konfirmua më 12 janar 2007.

Më 29 maj 2007 dhe 6 qershor 2007, Prokuroria njoftoi Dhomën Gjyqësore në lidhje me identifikimin e kufomave të dy viktimave që në aktakuzë përmendeshin si viktimat anonime dhe rrjedhimisht kërkoi autorizim për ndryshimin e aktakuzës së ndryshuar për herë të dytë dhe të rishikuar. Autorizimi u miratua më 5 shtator 2007 dhe aktakuza e ndryshuar për herë të tretë u konfirmua nga Dhoma Gjyqësore si

dokumenti në fuqi për këtë çështje. Më 7 shtator 2007 Prokuroria dorëzoi aktakuzën e ndryshuar për herë të tretë.

Më 27 shtator 2007, Prokuroria njoftoi Dhomën Gjyqësore për identifikimin e kufomës së një viktime tjetër që në aktakuzë përmendej si viktimë e paidentifikuar dhe rrjedhimisht më 28 shtator 2007 kërkoi autorizim për ndryshimin e aktakuzës së ndryshuar për herë të tretë. Kërkesa u miratua më 15 tetor 2007 dhe aktakuza e ndryshuar për herë të katërt u konfirmua si dokumenti në fuqi. Më 16 tetor 2007 Prokuroria dorëzoi aktakuzën e ndryshuar për herë të katërt.

Pretendohej se Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj ishin bashkëfajtorë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK). Qëllimi i NPK-së ishte konsolidimi i kontrollit tërësor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) mbi Zonën Operative të Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe nëpërmjet keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë, civilëve romë/egjiptianë kosovarë dhe civilëve të tjerë të cilët bashkëpunonin ose konsideroheshin se kishin bashkëpunuar me forcat serbe ose se nuk e kishin përkrahur UÇK-në.

Në Aktakuzë parashtrohej se pas 24 marsit 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e Ramush Haradinajt nisën një fushatë ushtarake për marrjen nën kontroll të rajonit ndërmjet fshatrave të Glllogjanit dhe Deçanit dhe në veçanti fshatrat Dubravë, Irzniq, Ratishë dhe Dashinoc dhe për largimin e serbëve etnikë nga fshatrat ku jetonin, dhe se po këto forca vazhduan sulmet kundër kampit të refugjatëve në Baballoq afër Deçanit (ky kamp kishte qenë objekt sulmesh të ngjashme të UÇK-së që nga viti 1997). Në Aktakuzë gjithashtu parashtrohej se forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e Ramush Haradinajt, ndër të cilat edhe "Shqiponjat e Zeza" nën komandën e drejtpërdrejtë të Idriz Balajt, keqtrajtoan, rrahën ose ndryshe larguan civilët serbë dhe civilë romë/egjiptianë nga këto fshatra, dhe vranë civilët që mbetën pas ose refuzuan të linin shtëpitë, dhe se ata vazhduan të kryenin sulme të ngjashme kundër civilëve serbë, civilëve shqiptarë kosovarë dhe civilëve romë/egjiptianë kosovarë.

Sipas aktakuzës, në mes të majit 1998 u ngrit një objekt i improvizuar burgimi në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Gjatë burgimit, të burgosurve u jepej shumë pak ushqim dhe ujë, rriheshin rregullisht dhe ata pësuan keqtrajtim fizik në forma të tjera dhe iu refuzua trajtimi mjekësor për lëndimet e tyre. Një numër të burgosurish në objektin e burgimit të Jabllanicës vdiqën si pasojë e lëndimeve të tyre ose u ekzekutuan me urdhër të të Akuzuarve.

Në Aktakuzë gjithashtu pretendohet se gjatë fundit të gushtit dhe fillimit të shtatorit 1998, forcat serbe ripushtuan përkohësisht rrethinën e Glllogjanit, dhe se një ekip serb i mjekësisë ligjore për vendin e krimit kreu hetime në atë rajon. Ata gjetën 32 kufoma të identifikueshme në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit. Gjithashtu ekipi gjeti dy kufoma në rrugën për në Dashinoc, afërsisht nëntë kilometra prej Glllogjanit.

Aktakuza i ngarkoi të akuzuarit me krimet e mëposhtme:

Ramush Haradinaj u akuzua në bazë të përgjegjësisë penale individuale (paragrafi 1 i Nenit 7 të Statutit) për:

- Përndjekje (keqtrajtim, torturim, dëbim ose zhvendosje të dhunshme të civilëve, vrasje, përdhunim) (krime kundër njerëzimit, Neni 5)
- Trajtim mizor, vrasje, torturim, përdhunim (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3)

Idriz Balaj u akuzua në bazë të përgjegjësisë penale individuale (paragrafi 1 i Nenit 7 të Statutit) për:

- Përndjekje (keqtrajtim, torturim, dëbim ose zhvendosje të dhunshme të civilëve, vrasje, përdhunim) (krime kundër njerëzimit, Neni 5)
- Trajtim mizor, vrasje, torturim, përdhunim (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3)

Lahi Brahimaj u akuzua në bazë të përgjegjësisë penale individuale (paragrafi 1 i Nenit 7 të Statutit) për:

- Përndjekje (keqtrajtim, torturim, dëbim ose zhvendosje të dhunshme të civilëve, vrasje, përdhunim) (krime kundër njerëzimit, Neni 5)

- Trajtim mizor, vrasje, torturim (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3)

## FAZA PARAGJYQËSORE

Më 6 qershor 2005 Haradinajt iu miratua lirim i përkohshëm. Sipas vendimit të Dhomës Gjyqësore, gjatë periudhës së parë nëntëdhjetëditëshe, Haradinaj nuk lejohej të bënte asnjë paraqitje publike ose të merrte pjesë në ndonjë veprimtari politike publike.

Në përgjigje të një kërkesë të Haradinajt, Dhoma Gjyqësore në vendimin e saj të 12 tetorit 2005 e lejoi Haradinajn të bënte paraqitje publike dhe të merrte pjesë në veprimtari politike në Kosovë në varësi të kushtëzimeve konkrete.

Më 14 tetor 2005, pas një mocioni të parashtruar nga Prokuroria, Dhoma Gjyqësore urdhëroi pezullimin e vendimit të saj të 12 tetorit 2005.

Më 16 dhjetor 2005, Dhoma e Apelit vendosi të pezullonte vendimin e Dhomës Gjyqësore të dhënë më 12 tetor 2005, që e lejonte Haradinajn "të bëjë paraqitje publike dhe të marrë pjesë në veprimtari politike publike". Me fjalë të tjera kushtet e përcaktuara në Vendimin për Lirim të Përkohshëm të Ramush Haradinajt do të vlenin deri në shqiptimin e vendimit të formës së prerë nga Dhoma e Apelit.

Më 10 mars 2006, Dhoma e Apelit me shumicë votash lëshoi një Vendim mbi lirimin e përkohshëm të ndryshuar të Ramush Haradinajt, në të cilën hidhej poshtë mocioni i Prokurorisë për anulimin e vendimit të Dhomës Gjyqësore të 12 tetorit 2005, dhe lejohej paraqitja publike e Haradinajt dhe pjesëmarrja e tij në veprimtari politike.

Haradinaj u kthye në Njësinë e Paraburgimit të OKB-së më 26 shkurt 2007 për fillimin e gjyqimit.

## GJYKIMI

Gjykimi i Haradinajt, Balajt dhe Brahimajt filloi më 5 mars 2007. Dhoma Gjyqësore shpalli mbylljen e procedimit të çështjes prej Prokurorisë më 26 nëntor 2007.

Më 29 nëntor 2007, të tre ekipet mbrojtëse raportuan se asnjë nga ta nuk do të paraqiste dëshmitarë.

Argumentet përmblyëse u dëgjuan nga 21 deri më 23 janar 2008.

## AKTGJYKIMI I DHOMËS GJYQËSORE

Dhoma Gjyqësore e shpalli vendimin më 3 prill 2008. Në hyrje të vendimit, Dhoma Gjyqësore theksoi se megjithëse kishte marrë dëshmitë e afërsisht 100 dëshmitarëve, gjithsesi "kishte hasur në vështirësi të konsiderueshme për marrjen e dëshmive nga një numër i madh i dëshmitarësh. Shumë individë përmendën frikën si arsye parësore për mosgatishmërinë e paraqitjes para Dhomës Gjyqësore për dhënie dëshmie. Dhoma Gjyqësore krijoi përshtypjen e fortë se procesi gjyqësor po zhvillohej në një atmosferë që i bënte dëshmitarët të ndjeheshin të rrezikuar për shkak të një numri faktorësh të lidhur me Kosovën si lidhjet e ngushta familjare dhe shoqërore si dhe ndërvarësia e këtyre lidhjeve të cilët e bënë të vështirë garantimin e anonimitetit. Vetë palët pranuan se në Kosovë ekzistonte gjendje e paqëndrueshme e sigurisë e cila ishte veçanërisht negative për dëshmitarët. Në këto rrethana Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi të gjitha kompetencat që i akordonte Rregullorja për të garantuar procedim të drejtë dhe të shpejtë si dhe mbrojtjen dhe mirëqenien e dëshmitarëve që u paraqitën". Gjatë procesit gjyqësor u miratuan disa masa mbrojtëse gjithsej për 34 dëshmitarë.

Pasi shqyrtoi provat e paraqitura mbi pika të veçanta të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore konkludoi se një numër i madh i krimeve të pretenduara u kryen prej ushtarëve të UÇK-së, ose prej personave të lidhur me UÇK-në. Në këto krime në veçanti përfshihen keqtrajtimi i personave të mbajtur në shtabin e Jabllanicës. Dhoma konkludoi se ushtarët e UÇK-së në këtë vend ose persona të lidhur me UÇK-në, rrahën egërsisht Dëshmitarin 6, Nenad Remishtarin /Nenad Remištar/, Pal Krasniqin, Skënder Kuqin, Dëshmitarin 3, tre malazezë të paidentifikuar dhe një bosnjak të paidentifikuar. Keqtrajtimi i këtyre personave përbën trajtim mizor dhe në disa raste torturim. Gjithashtu Dhoma konkludoi se dy prej këtyre individëve, Skënder Kuqi dhe Pal Krasniqi, vdiqën si pasojë e keqtrajtimit.

Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se ushtarët e UÇK-së morën në pyetje dhe keqtrajtuar Novak Stijoviqin /Novak Stijović/ dhe Stanisha Radosheviqin /Staniša Radošević/ jashtë Glogjanit në prill 1998, pasi të dy personat ishin ndaluar në një postbllok të UÇK-së. Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se një ushtar i UÇK-së përdhanoi Dëshmitaren 61 në shtabin e UÇK-së në Irzniq dikur në verë të vitit 1998. Keqtrajtimi i këtyre personave përbente trajtim mizor dhe torturim.

Prokuroria i kishte akuzuar tre të Akuzuarit për 30 vrasje ku kufomat e viktimave u gjetën në rrethinën e kanalit të Radoniqit. Mirëpo Dhoma konkludoi se vetëm shtatë prej këtyre vrasjeve mund të vërtetoheshin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që ishin kryer prej ushtarëve të UÇK-së. Të vrarët ishin Zenun Gashi, Nuriye Krasniqi, Istref Krasniqi, Sanije Balaj, dhe nëna e dy motrat e Dëshmitarëve 4 dhe 19. Dhoma mori më pak prova për shumicën e pretendimeve të tjera për vrasje. Në disa raste, nuk dihej asgjë për rrethanat e zhdukjes së viktimës. Disa kufoma të gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk u identifikuan. Edhe vrasjet për të cilat Dhoma mori prova të shumta nuk mund t'i atribuoheshin gjithmonë UÇK-së. Si pasojë, Dhoma nuk mundi të nxirrte përfundime të një karakteri më të përgjithshëm për identifikimin e autorëve të krimeve dhe përkatësinë e tyre vetëm prej faktit se në rrethinën e kanalit të Radoniqit u gjetën viktima.

Si përfundim, Dhoma konkludoi se ushtarë të UÇK-së kryen veprat e trajtimit mizor, torturimit, përdhunimit dhe vrasjes, të formuluar në:

- Pikën 6,
- Pikën 14,
- Pikën 20,
- Pikën 22, por vetëm në lidhje me vrasjet e Nuriye dhe Istref Krasniqit dhe vrasjen e Sanije Balajt,
- Pikën 28,
- Pikën 30,
- Pikën 32, dhe
- Pikat 36 dhe 37, por vetëm në lidhje me Dëshmitarin 61.

Prokuroria i akuzoi të tre të Akuzuarit për këto krime si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK). Synimi i kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të pretenduar ishte konsolidimi i kontrollit tërësor të UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë, dhe keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë dhe romë kosovarë, si dhe të civilëve të tjerë të cilët bashkëpunonin ose mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe apo, ndryshe, nuk përkrahnin UÇK-në. Dhoma konkludoi se Prokuroria paraqiti pak prova të drejtëpërdrejta në mbështetje të pretendimit mbi synimin e përbashkët kriminal. Si alternativë Prokuroria kërkoi që Dhoma të konkludonte nga provat rrethore, kryesisht nga provat për krimet e kryera nga ushtarët e UÇK-së, se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale. Pas shqyrtimit të provave të drejtëpërdrejta dhe provave rrethore, Dhoma Gjyqësore nuk u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se tre të Akuzuarit morën pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

Ndryshe, secili prej të Akuzuarve u akuzua për kryerje, planifikim, nxitje, urdhërim, apo ndihmë dhe inkurajim të shumë prej krimeve. Dhoma Gjyqësore gjykoj se kishte marrë prova të mjaftueshme për t'u bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për përgjegjësinë individuale penale të një të Akuzuari, Lahi Brahimaj, për dy pika të akuzave alternative.

Sipas Prokurorisë me datën 13 qershor 1998 apo rreth kësaj date, ushtarë të UÇK-së arrestuan Dëshmitarin 6 pasi kontrolluan makinën e tij dhe gjetën një armë zjarri. Më tej, sipas Aktakuzës, Dëshmitari 6 u mbajt në shtabin e Jabllanicës ku u rrah rregullisht nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Brahimajt. Në bazë të provave të paraqitura, Dhoma Gjyqësore u bind se Dëshmitari 6 u mbajt në shtabin e Jabllanicës afërsisht për gjashtë javë, duke filluar me 13 qershor 1998 apo rreth kësaj date. Përafërsisht gjatë katër javëve të para, ai u rrah rregullisht nga ushtarët e UÇK-së, gjë që i shkaktoi vuajtje dhe lëndime të rënda dhe rezultoi në pasoja të përhershme fizike. Gjithashtu Dëshmitari 7 dhe Dëshmitari 16 dëshmuan se një komandant në shtab u tha atyre se Dëshmitari 6 ishte dënuar. Komandanti foli me mllef kundër Kryetarit Rugova dhe kundër atyre që nuk luftonin. Vetë Dëshmitari 6 dëshmoi se më 25 korrik atij iu dha vendimi me shkrim i lirim me nënshkrimin e Brahimajt ku pohohej se lirimi i tij ishte i kushtëzuar dhe se ai do të procedohej në rast se i përsëriste “gabimet”. Në bazë të kësaj dëshmie, Dhoma Gjyqësore u bind se ushtarët e UÇK-së e keqtrajtuan Dëshmitarin 6 për ta ndëshkuar. Për këtë arsye, Dhoma përfundoi se Dëshmitari 6 ishte viktimë e trajtimit mizor dhe torturimit, kryer nga ushtarët e UÇK-së ose nga persona të lidhur me UÇK-në.

Dëshmitari 6 dëshmoi se Brahimajt mori pjesë disa herë në rrahjen e tij dhe se, herë pas here, ishte i pranishëm kur dëshmitari u rrah prej të tjerëve. Dëshmitari 6 dëshmoi gjithashtu se Brahimajt, ishte ndër ata që e akuzuan se kishte qenë me serbët dhe kishte spiunuar për ta. Dëshmitari 6 pati mundësi të shumta për të vëzhguar Lahi Brahimaj gjatë periudhës përafërsisht katërjavore kur e rrahën. Gjithashtu Dëshmitari 6 dëshmoi se, gjatë dy-tri javëve më vonë, ai e pa Lahi Brahimaj disa herë në shtabin e Jabllanicës. Dëshmitari 6 dëgjoi se si të tjerët e quanin Lahi apo Magjup, dhe mësoi se Magjup ishte nofka e Lahi Brahimajt. Më vonë, Dëshmitari 6 e njohu Lahi Brahimaj në një fotomontazh të Prokurorisë. Bazuar në tërësinë e provave, Dhoma Gjyqësore u bind se Lahi Brahimajt mori pjesë personalisht në trajtimin mizor dhe në torturimin e Dëshmitarit 6, dhe konkludoi se ai duhej dënuar për kryerjen e këtyre krimeve.

Gjithashtu, Prokuroria pretendoi se në korrik të vitit 1998, Dëshmitari 3 u mbajt në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u rrah keqazi prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore u bind se Dëshmitari 3 u rrah nga ushtarët e UÇK-së ose nga persona të lidhur me UÇK-në, të cilat i shkaktuan vuajtje të rënda fizike dhe se kryesit synonin të shkaktonin vuajtje të tilla. Dhoma Gjyqësore gjithashtu u bind se rrahjet e Dëshmitarit 3 ishin ndëshkim për mosdorëzimin e armës prej tij dhe për t’u diskriminuar për lidhjet e tij të pretenduara me serbët. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në kryen trajtim mizor dhe torturim kundër Dëshmitarit 3.

Dhoma arriti në përfundimin se roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje si dhe pozita e tij eprore vërtetuan synimin e tij për t’i shkaktuar vuajtje të rënda fizike Dëshmitarit 3, si ndëshkim për mosdorëzimin e armës prej tij dhe për ta diskriminuar për lidhjet e tij të pretenduara me serbët. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Lahi Brahimajt duhej dënuar për kryerjen e trajtimit mizor dhe të torturimit sipas Pikës 32.

Për krimet e tjera të Pikave 6, 20, 30, 36 dhe 37, Dhoma konkludoi se Prokuroria kishte paraqitur prova të pamjaftueshme për vërtetimin e përgjegjësisë penale të të Akuzuarve.

Në Pikën 14, Idriz Balaj akuzohej se kreu, planifikoi, nxiti apo ndihmoi në kryerjen e vrasjeve të nënës dhe të dy motrave të Dëshmitarëve 4 dhe 19. Konkluzioni i shumicës së Dhomës Gjyqësore ishte se nuk kishte prova se Idriz Balaj, me vetëdije kontribuoi apo ndihmoi në kryerjen e ndonje vrasjeje, dukë vënë në dukje në veçanti mungesën e provave se në atë kohë ai ishte në dijeni se u kryen apo do të kryheshin vrasjet. Gjykatësi Höpfer shprehu mospajtim përse i përket përgjegjësisë penale të Idriz Balajt në ndihmën dhe inkurajimin për vrasjen e motrës “S”.

Më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore shqiptoi vendimin: Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj u shpallën të pafajshëm për të gjitha akuzat në Aktakuzë. Dhoma Gjyqësore urdhëroi lirimin e tyre.

Lahi Brahimajt u shpall fajtor në bazë të përgjegjësisë penale individuale për:

- trajtim mizor dhe torturim (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Nenit 3)

Dënimi: gjashtë vjet burgim.

1109 ditë të kaluara në paraburgim u llogaritën si ditë burgimi.

## AKTGJYKIMI I DHOMËS SË APELIT

Seanca e apelit u zhvillua më 28 tetor 2009.

Në pikën e parë të apelit të saj Prokuroria argumentoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur refuzoi kërkesat e Prokurorisë për kohë shtesë për shfrytëzimin e të gjitha hapave të arsyeshme për të mundësuar dhënie dëshmie prej dy dëshmitarëve kyç dhe urdhëroi mbylljen e procedimit të çështjes së Prokurorisë para marrjes së këtyre masave të arsyeshme. Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Robinson e miratoi këtë pikë të apelit dhe urdhëroi rigjykim të pjesshëm. U konkludua se çdo vendim i Dhomës Gjyqësore i marrë veçazi dhe jashtë kuadrit të gjykimit është brenda kompetencës së brendaqenësishme të Dhomës Gjyqësore, mirëpo duke i shqyrtuar këto vendime së bashku, dhe konkretisht në kuadrin e frikësimit të rëndë të dëshmitarëve që karakterizoi procesin gjyqësor, dilte qartë se Dhoma Gjyqësore gaboi rëndë kur nuk mori masat e mjaftueshme për të mundësuar dhënien e dëshmisë prej disa dëshmitarëve.

Pika e dytë e apelit të Prokurorisë u hodh poshtë, pika e tretë u miratua pjesërisht, megjithëse u la në fuqi pafajësia e Balajt në lidhje me pikën përkatëse (37).

Dhoma e Apelit hodhi poshtë pikat 1-8 dhe 10-19 të apelit të Lahi Brahimajt. Dhoma e Apelit miratoi pjesërisht pikën e nëntë të apelit të Brahimajt, por rrëzoi të gjitha aspektet e tjera dhe la në fuqi fajësinë e Brahimajt për torturim në lidhje me pikën 32 të aktakuzës.

Më 21 korrik 2010, Dhoma e Apelit shqiptoi vendimin e vet dhe shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore:

(a) që kishte shpallur të pafajshëm Haradinajn dhe Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës;

(b) që kishte shpallur të pafajshëm Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe 34 të Aktakuzës;

(c) që kishte liruar Haradinajn, Balajn dhe Brahimajn prej përgjegjësisë penale individuale në lidhje me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe

(d) që kishte liruar Brahimajn prej përgjegjësisë penale individuale në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës.

Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykimin e Haradinajt, Balajt dhe Brahimajt në lidhje me këto pika.

## RIGJYKIMI

Rigjykimi filloi më 18 gusht 2011.

Prokuroria e përfundoi paraqitjen e provave të veta më 20 prill 2012.

Mbrojtja nuk paraqiti asnjë dëshmitar. Argumentet përmbyllëse u dëgjuan nga 25 deri më 27 qershor 2012.



## AKTGJYKIMI I RIGJYKIMIT

Në lidhje me gjashtë pikat e Aktakuzës për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Dhoma nxori përfundimet e mëposhtme:

Pika 3:

Më 13 qershor 1998, në rrugën midis Gjakovës dhe Klinës, ushtarë të UÇK-së rrëmbyen Dëshmitarin 6, shqiptar kosovar i besimit katolik. Ai u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për rreth gjashtë javë, ku u rrah vazhdimisht nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj. Dëshmitari 6 u akuzua se shoqërohej me serbë dhe se ishte spiun i tyre. Më 25 korrik 1998, Nazmi Brahimaj e liroi Dëshmitarin 6 nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma u bind se ishin vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 6. Lahi Brahimaj nuk u akuzua për këtë pikë.

Pika 4:

Më 13 qershor 1998, në rrugën midis Klinës dhe Gjakovës, ushtarë të UÇK-së nxorën nga makina e tij Nenad Remishtarit, polic serb i komunikacionit rrugor. Ai u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u rrah keqas nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Të nesërmen, më 14 qershor 1998, Nenad Remishtari u nxor nga dhoma ku mbahej i burgosur në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe që atëherë nuk është parë më. Dhoma u bind se ishin vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Nenad Remishtarit. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë lidhur me çfarë ndodhi me Nenad Remishtarit pas nxjerrjes së tij nga dhoma në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Në ato rrethana, Dhoma konkludoi se vrasja e Nenad Remishtarit nuk ishte vërtetuar. Dikur nga fundi i qershorit 1998, një boshnjak dhe tre malazezë të paidentifikuar u sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u rrahën dhe u goditën me thikë nga ushtarë të UÇK-së në praninë e Nazmi Brahimajt dhe Hamza Brahimajt. Boshnjaku i paidentifikuar u akuzua për ndërprerje të rrymës elektrike. Dhoma u bind se ishin vërtetuar akuzat për trajtimin mizor të këtyre katër meshkujve, si dhe akuza për torturim të boshnjakut të paidentifikuar. Në mungesë të provave se tre malazezët e paidentifikuar u keqtrajtuuan me synimin e nevojshëm për torturim, Dhoma konkludoi se nuk ishte vërtetuar akuza për torturim të tre malazezëve.

Pika 5:

Dhoma u bind se ishin vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Skënder Kuqit, Pal Krasniqit dhe Dëshmitarit 3. Lahi Brahimaj nuk u akuzua për këtë pikë. Më 15 apo 16 korrik 1998 ose rreth këtyre datave, pas përpjekjes së tij të pasuksesshme për t'u arratisur nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Skënder Kuqi u rrah shumë keq dhe më pas u çua në spital ku edhe vdiq. Dhoma u bind se vdekja e Kuqit ishte pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga rrahjet që pësoi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë kështu që akuza për vrasjen e Kuqit ishte vërtetuar. Pal Krasniqi pësoi rrahje të rënda dhe të vazhdueshme në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dëshmitari 6 e pa për herë të fundit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, më 25 korrik 1998. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998, në kanalën e liqenit të Radoniqit me lëndime në kokë, trup dhe duar, të shkaktuara nga armë zjarri. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë lidhur me rrethanat e vdekjes së tij. Në rrethana të tilla, Dhoma nuk mundi të konkludonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshem se ishte vërtetuar akuza e vrasjes së Krasniqit.

Pika 6:

Një ditë pas sulmit të forcave serbe kundër fshatit Grabanicë, më 19 maj 1998, ose rreth kësaj date, ushtarë të UÇK-së nxorën me dhunë Naser Likën dhe Fadil Fazliun nga një shtëpi në Zhabel. Gjatë këtij incidenti, ushtarët e UÇK-së i quajtën Fadil Fazliun dhe Naser Likën "tradhtarë" duke i rrahur dhe shkelmuar. Dhoma u bind se ishin vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Naser Likës dhe Fadil Fazliut në lidhje me largimin e tyre të dhunshëm nga Zhabeli.

Rrjedhimisht Dhoma u bind se ishin vërtetuar Pikat 3, 4, 5 dhe largimi i dhunshëm i Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli prej ushtarëve të UÇK-së, sikundër pretendohet në Pikën 6.

Dhoma konkludoi se nuk ishin vërtetuar Pika 1 dhe Pika 2 e Aktakuzës si edhe një pjesë e Pikës 6 (në lidhje me keqtrajtimin e Naser Likës, shqiptar kosovar, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë).

Në lidhje me ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (NPK) të pretenduar në Aktakuzë, Dhoma konkludoi se nuk ishte vërtetuar qëllimi i përbashkët i NPK-së. Rrjedhimisht, Haradinaj dhe Balaj nuk ishin penalisht përgjegjës për pjesëmarrje në NPK në lidhje me akuzat për krime në Pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Aktakuzës. Brahimaj nuk ishte penalisht përgjegjës për pjesëmarrje në NPK në lidhje me akuzat për krime në Pikat 4 dhe 6 të Aktakuzës.

Më 29 nëntor 2012, Dhoma shpalli aktgjykimin duke i shpallur të tre të akuzuarit të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.